

NEKTARI  
*PËR*  
VOGËLUSHËT

MELAIM SHEHU

# NEKTARI PËR VOGËLUSHËT

Melaim Shehu

Titulli i librit:

**Nektari për vogëlushët**

Autori:

**Melaim Shehu**

Recensentë:

**Miftar Ajdini**

**Nexhat Ibrahim**

Lektor:

**Xhevat Xhoxhaj**

Botues:

**“ZËRI ISLAM” Prizren**

Përgatitja kompjuterike:

**Muhamed Shehu**

*‘Në emër të Allahut, të  
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

## PARATHËNIE

Falenderimi është për Allahun, të Vetmin, të Gjithëfuqishmin, Falësin Fuqiplotë, i Cili e mësoi njeriun të shkruaj me penë, pastaj i mësoi njeriut atë që nuk e dinte. Dëshmoj se nuk ka zot përveç Allahut dhe dëshmoj se peygamberi ynë Muhammedi s.a.v.s. është rob dhe i dërguar i Tij, i dashuri dhe i zgjedhuri i Tij, udhëzues në rrugë të drejtë dhe thirrës në fenë burimore. Shpëtimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, mbi të gjithë peygamberët dhe familjet e tyre si dhe mbi njerëzit e mirë.

## Lexues të nderuar!

Me gjithë vullnetin e mirë dhe mundin e derdhur, në mënyrë që kjo përmbledhje rrëfenjash të dalë sa më cilësore, jam i vetëdijsëm për mungesat dhe lëshimet që – mund të - gjenden në te. Megjithatë, jam i bindur se këto rrëfenja edukative do të plotësojnë një zbrazësi për vogëlushët tanë, të cilët janë të etshëm për udhërrëfime.

Për përpilimin e kësaj vepre modeste “*Nekatori për vogëlushët*”, jam shërbyer me literaturë klasike dhe bashkëkohore, të cilat paraqesin një trashëgim edukativ tejet të rëndësishëm.

“*Nektari për vogëlushët*” përbëhet prej dhjetë kapitujve. Secili kapitull përmban nga tri rrëfime, tregime a tema të një tematike

përafërsisht të ngjashme. Në të janë përfshirë gjithsej tridhjetë tregime. Ndoshta ndonjëri prej tyre nuk meriton të gjendet në këtë përmbledhjeje, por...

Me gjithë përpjekjet e mia të sinqerta, *Veprat janë sipas qëllimeve...*, që ta bëj këtë përmbledhje sa më të përshtatshme dhe sa më të kapshme, duhet të pranoj se nuk më ka shkuar gjithmonë për dore përkthimi, përshtatja a përzgjedhja, aq më parë kur dihet se letërsia edukativo-islame është shumë e pasur.

Punën time në këtë vepër modeste e kanë ndërlikuar kushtet dhe rrethanat e vështira, si dhe mënyra josistematike e punës, për shkak të preokupimit me telashet mërgimtare.

Qëllimi im ka qenë dhe mbetet, që me një vepër modeste të këtillë, të jap

një ndihmesë sado të thjeshtë, për brezin e ri. Sa ia kam qëlluar s'kam se çka të flas, por le të flet vetë vepra!

Në fund, u shprehi mirënjohjen time, të gjithë atyre të cilët më sugjeruan, në mënyrë që “Nektari për vogëlushët” të jetë sa më cilësor dhe të dalë një ditë në dritë.

Jam i gatshëm të pranoj çdo sugjerim, vërejtje a kritikë dhe “Le ta mëshirojë Allahu xh.sh. atë njeri që gabimet e mia, mua m'i fali”. (Umer b. el- Hattabi r.a.).

Por nëse ka ndonjë kompliment, atëherë “O Zoti im, më bër edhe më të mirë se atë që ata thonë për mua, dhe m'i fal mëkatet e mia, për të cilat ata nuk i dinë”. (Ebu Beker es-Siddiku r.a.)

Amin ja Rabbe-l-alemin!



## KAPITULLI

## PARË



- Zoti nuk ka lind as  
nuk është i lindur

- Dëshiroj ta shoh  
Zotin

- Moskuptueshmëria  
s'është dëshmi për  
mosekzistencë





## I – 1            ZOTI    NUK    KA LIND, AS NUK ËSHTË I LINDUR!

Bij të mi të dashur! Fëmijë të mi të nderuar!

Pas një pushimi të shkurtër, filloi ora e edukatës fetare. Mësuesi Muhammed hyri në klasë me buzëqeshje duke i përshëndetur nxënësit e tij si zakonisht me përshëndetje islame "Es-selamu alejkum", "ve alejkumus-selam", përgjigjen nxënësit njëzëri, të gatshëm dhe me padurim presin ndonjë mësim të ri dhe të dobishëm nga mësuesi i tyre.

Në momentin kur mësuesi Muhammed deshi ta fillojë mësimin vërejti një nxënës që kishte ngritur dorën për ta pyetur, të cilit i dha leje.

Mësues i dashur, një ditë një bashkëvendas i imi, si duket është bir "i oldateistit" me pyeti: Meqë ti beson në Zot, atëherë kur ka lindur Zoti? Unë nuk isha në gjendje t'i përgjigjem, andaj, a ke mundësi të na shpjegoni diç lidhur me këtë.

Nxënës të dashur, në lidhje me këtë pyetje do të lexojmë suren El-ihlas, që sipas hadithit të peygamberit Muhammed a.s.: është sa një e treta e Kur'anit famëlartë.

"Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

*"Thuaj: Ai, Allahu është Një! Allahu është*

*Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për  
çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i  
lindur. Dhe Atij askush nuk i është i  
barabartë”.*

Megjithatë, nga dialogu vijues i Ebu Hanifes me skeptikët, që do t'ju tregoj, do të gjeni përgjigjen në pyetjen e parashtruar, andaj dëgjoni me vëmendje.

Një grup skeptikësh, shkuan te Ebu Hanifja, të cilit i parashtruan shumë pyetje, e ndër to dhe këto:

- Në cilin vit ka lindur Zoti yt?  
e pyeten ata.

Zoti im nuk ka lindur, se përndryshe do të kishte prindër. Për këtë Kur'ani famëlartë thotë:

As s'ka lindur kë, as nuk është i

lindur", përgjigjet Ebu Hanifja.

- Në cilin vit është krijuar Zoti yt? pyeten ata.

Zoti është Krijues i përhershëm pa fillim dhe pa mbarim. Ai ekziston para kohe dhe vendi dhe s' ka asgjë para Tij.

- Na shpjego me një shembull praktik, në mënyrë që ta kuptojmë më lehtë përgjigjen tënde, i thanë ata.

Cili është numri, para numrit tre? i pyeti Ebu Hanifja.

- Para numrit tre është numri dy, u përgjigjen ata. E para numrit dy ? pyeti Ebu Hanifja.

- Para numrit dy është numri një, u përgjigjen ata.

Po, para numrit një cili numër është? pyeti Ebu Hanifja.

- S'ka asgjë para numrit një, u  
përgjigjen ata.

-

**Nëse numri një nuk lejon që  
të ketë, dhe s'ka numër para tij,  
atëherë si të lejohet që para  
Krijuesit të ketë diç!**

- Ne kuptuam ekzistencën e  
Zotit, por na trego a është Ai i ngurtë  
si hekuri, apo i lëngët si uji apo si  
gazi? e pyeten ata.

Më përshkruani shpirtin e njeriut të  
gjallë dhe të vdekur, tha Ebu Hanifja.

- Ne nuk e shohim shpirtin, u  
përgjigjen ata.

Shpirti është krijesë, e ju nuk mund  
ta shihni, atëherë si dëshironi t'ju  
përshkruaj, ekzistencën hyjnore, Zotin,  
i cili është Krijues i shpirtit!

- Në cilin vend është Zoti? e pyeten ata .

Po të marrin një gotë me qumësht, vallë a është gjalpi në këtë gotë, i pyeti Ebu Hanifja.

- Po, u përgjigjen ata.

Ku gjendet gjalpi në qumësht ? i pyeti Ebu Hanifja.

- Ai nuk ka vend të posaçëm, por është i shpërndarë në qumësht, u përgjigjen ata.

Nëse gjalpi si krijesë nuk ka vend të posaçëm në qumësht, atëherë si dëshironi vend të posaçëm për ekzistencën e Zotit? u tha Ebu Hanifja. Zoti, është Ai i cili përfshin, e nuk përfshihet.

- Zoti çka vepron tani? e pyeten ata.

Kjo çështje është e natyrshme, njërin e ngritë, kurse tjetrin ezbret. Ai nuk e ndryshon gjendjen e një populli, për derisa pikërisht ai popull nuk e ndryshon gjendjen e vet.

Kur ata dëgjuan të gjitha këto përgjigje të përpikta, e lanë dhe e braktisen skepticizmin e tyre dhe u mbushen me besim të plotë.

Nxënës të dashur, besoj se e keni kuptuar përgjigjen në pyetjen e parashtruar. Po, thanë nxënësit.

Në këtë moment ra zilha për përfundimin e orës së edukatës fetare, mësuesi Muhammed doli nga klasa duke i përshëndetur nxënësit me përshëndetjen islame "Es- selamu alejkum", "ve alejkumus-selam" përgjigjen nxënësit, dhe ashtu të gëzuar për një mësim të ri të dobishëm thanë

njëzërit : **Zoti nuk ka lind, as nuk është i lindur.**

*Kush ma mësoi një urtësi, atëherë jam rob i tij.* (proverb arab). Bij të mi dashur! Fëmijë të mi të nderuar!

Para se të ndahemi, do t'ju prezentojmë disa ajete kur'anore si dhe disa hadithe të pejgamberit Muhammed a.s., lidhur me këtë temë, në mënyrë që t'i mësoni përmendsh dhe t'i praktikoni në jetë .

*“Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet, e ai tha: “O populli im, adhurojeni Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij. Unë kam frikë për dënimin Tuaj në një ditë të madhe!”* (El-A'raf, 59).

*Musai tha: “Mos deshët, pos Allahut, të kërkoj për ju zot tjetër, kurse Ai ju vlerësoi mbi njerëzit e tjerë?”* (El-A'raf, 140).



*Atëherë, dije se nuk ka Zot tjetër pos Allahut, kërko falje për mëkatin tënd, për të besimtarëve e të besimtareve, Allahu e di për lëshimet tuaja (për vepra) dhe për vendin tuaj. (Muhammed, 19).*

Ja tani disa hadithe të peygamberit Muhammed, paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të:

*"Njeri i mençur është ai që e kontrollon vetveten dhe punon për jetën pas vdekjes, kurse njeri i dobët është ai që ndjek dëshirat e epshit të vet dhe pa arsye (pa kurrfarë merite) shpreson se Allahu do t'ia falë".*

*" Frikësohu Allahut kudo që të jeshë, të keqën përcille me të mirë, ajo do ta fshijë të keqën. Dhe me njerëz bëhu i moralshëm, me moral dhe sjellje të mira ."*

*"Nga Islami i mirë i një njeriu është largimi nga ajo që nuk i përket".*

Vogëlushë të dashur!

Ejani me ne të mësojmë virtyte të tjera nga besimtarët, ku do të lexojmë një tregim tjetër të mësuesit Muhammed.

## I – 2 DËSHIROJ TA SHOH ZOTIN!

Bij të mi të dashur! Fëmijë të mi të nderuar !

Pas përfundimit të orës së gjuhës shqipe, dhe pushimit të shkurtër, filloi ora e edukatës fetare. Mësuesi Muhammed hyri në klasë me buzëqeshje duke i përshëndetur nxënësit e tij si zakonisht me përshëndetjen islame "Es-selamu alejkum", "ve alejkumus- selam", përgjigjen nxënësit njëzëri, të gatshëm dhe me padurim presin ndonjë mësim të ri dhe të dobishëm nga mësuesi i tyre.

Në momentin kur mësuesi Muhammed deshi ta fillojë mësimin vërejti një nxënës që kishte ngritur dorën për ta pyetur, të cilit i dha leje.

Mësues i dashur, një ditë shoku im, bir "i oldateistit" me pyeti: Meqë ti beson se ekziston Zoti, atëherë ma trego ta shoh, në mënyrë që dhe unë pastaj të besoj në Zot! Unë nuk isha në gjendje t'i përgjigjem. Andaj a ke mundësi të na shpjegoni diç lidhur me këtë.

Nxënës të dashur, në lidhje me këtë pyetje kemi një ajet kur'anor ku thuhet:

*“Të dërguarit e tyre u thanë: “A mos keni dyshim në Allahun, Krijuesin e qiejve e të tokës? Ai ju thërret (në besim) për t’ju falur mëkatet dhe për t’ju vazhduar (jetën) deri në një afat të caktuar!” Ata thanë: “Ju nuk jeni tjetër pos njerëz siç jemi edhe ne, ju dëshironi të na pengoni nga ajo që adhuroni prindërit tanë, pra na sillni ndonjë argument të qartë!” (Ibrahim, 10).*

Por, nga ky tregim, që do t'ju tregoj,  
do të gjeni përgjigjen në pyetjen e  
parashtruar, andaj dëgjoni me  
vëmendje.

Një mbret në Lindjen e Largët,  
hetoj se po i afrohet fundi i jetës së tij,  
andaj e kaploi një brengë e hall dhe  
filloi të mendojë me një rënkim:

Asgjë në jetën time, nuk më kaloi pa  
e parë, pa e njohur dhe pa e shijuar,  
por vetëm një çështje më mbeti  
enigmatike, kauza për ekzistencën e  
Zotit, respektivisht Zotin nuk e kam  
parë, andaj dëshiroj ta shoh Zotin! Kjo  
është dëshira ime e flaktë njëkohësisht  
edhe e fundit!

Ai, më pastaj i urdhëroi oborrtarët,  
dijetarët dhe teologët, duke u thënë:  
Dëshiroj ta shoh Zotin! Nëse nuk më  
plotësohet kjo dëshirë e flaktë, dhe

nëse nuk ma tregoni mënyrën se si ta shoh Zotin, atëherë ju s'do ta shihni diellin me sy, dhe do t'ju ndëshkoj me një dënim të tmerrshëm!

Ai, për zgjidhjen e një kauze të tillë, ju dha afat vetëm tre ditë. Ata, duke e kuptuar mirë se mbreti nuk shpotitet, por është tejet serioz, u gjenden në një shtrëngim dhe në hall, sepse nuk dinin sesi t'ia dalin në krye! Vallë, si t'ia plotesojnë dëshirën e tij të fundit? Ata nuk gjeten zgjidhje për plotësimin e dëshirës së mbretit.

Në mesditë të ditës së tretë, mbreti i thërret ata. Të gjithë oborrtarët, dijetarët dhe teologët shkuan tek mbreti, por të frikësuar, meqë dënimi i tmerrshëm ndaj tyre ishte i pashmangshëm. Por ja, para se t'ju shqiptojë dënimin, para dyerve të pallatit mbretëror, u paraqit një bari, i cili kërkoi nga roja që të hyjë te mbreti,

për t'ju përgjigjur në dëshiren e tij të fundit.

Kur mbreti dëgjoji për këtë, dha urdhër që të hyjë. Pasi hyri bariu, aty për aty mbreti i dha lejë që të përgjigjet në pyetjen, respektivisht në dëshiren e tij të fundit.

Më lejo, mbret i nderuar, që unë ta plotësojë dëshirën tënde të fundit, i tha bariu.

Mirë, por nëse nuk përgjigjesh në mënyrë adekuate, dhe nëse nuk më plotësohet kjo dëshirë, atëherë s'ke për ta parë diellin me sy, dhe ka për të kushtuar me kokë!

Të dalim në taracë, i tha bariu mbretit. Pasi që ata dolën në taracë, bariu shtriu dorën në drejtim të diellit duke i thënë mbretit:

I nderuari mbret, shiko në drejtim

të dorës sime!

Mbreti shikoi në drejtim të diellit, por me të shpejt e largoi shikim dhe e kthej kokën në anën tjetër dheitha duke i pëcërruar sytë:

Ti dëshiron të më verbosh duke shikuar diellin! Si mund ta shoh atë dritë aq të madhe?

Mbret i nderuar, këtë që tentove ta shohësh, është vetëm një vepër e Krijuesit, respektivisht një nga krijesat e Tij. **Ajo është një nga gacat e vogla, të cilën e ka ndezur Krijuesi. Përkundër kësaj, edhe pse është gacë shumë e vogël, në krahasim me të tjera, sytë ty nuk janë në gjendje ta shohin, e të mos flasim për gacat, krijesat e tjera.** Por, nëse dëshiron ta shohësh Zotin, Krijuesin



e gjithësisë, atëherë kërkoje me të menduar, me përsiatje dhe në mënyrë të logjikshme, duke shfrytëzuar arsyen e jo vetëm shqisën e të pamurit. Kërko Atë në veten tënde. Njihe vetën atëherë do ta njohësh dhe do ta shohësh Zotin.

Vërtet ti qenke njeri i urtë, unë, plotësisht pajtohem me mendimin tënd, por me thuaj këtë: Çka ka para Tij?

Bariu u mendua një çikë, pastaj tha: Zotëri, numëro! Mbreti filloi të numërojë : Një, dy tre, katër, pesë... Jo, joendërpreu bariu. Por, numëro nga një numër mëimadh.

Mbreti filloi të numërojë: Nëntë, tetë, shtatë, gjashtë, pesë, katër, tre, dy, dhe një. E pastaj, e pyeti bariu.

Pastaj nuk ka asgjë. Para numrit një

nuk ka asgjë. Meqë numri matematikor nuk lejon që para numrit një të këtë ndonjë numër, u përgjigj mbreti.

**Zotëri, meqë numri një nuk lejon që të këtë ndonjë numër para tij, atëherë si të lejojë Krijuesi i gjithësisë që të këtë ndonjë para Tij. Andaj para Krijuesit, nuk mund të mendohet të këtë ndonjë tjetër, tha bariu.**

Mbretit i pëlqeu dhe kjo përgjigje, megjithatë ia parashtroi dhe një pyetje të fundit:

Çka vepron Krijuesi i gjithësisë?

Bariu mendoi pak, pastaj tha: Pyetje me vend. Po ashtu dhe për këtë do të

përgjigjem por më lejo që për një moment t'i ndërrojmë rrobat. Ti, veshi rrobat e mia, kurse unë do t'i veshi

rrobat tua.

Mbreti, pranoi një gjë të tillë. Për një kohë të shkurtër, bariu i veshi rrobat e mbretit, kurse mbreti i veshi rrobat e bariut si dhe e vuri torbën e tij në supë. Pastaj bariu hipi në fron të mbretit, vuri kurorën mbretërore në kokë, mori shkeptren në dorë dhe u kthye në drejtim të mbretit duke i thënë:

Këtë që bëmë ne tani, pikërisht kësioj vepron Zoti i gjithësisë më të tjerë. Ai njërin e gradon, kurse tjetrin e degradon. Kështu që **mos mendo ti se përherë do të jesh në atë pozitë mbretërore. Por, koha punon një ditë për ty, e një ditë tjetër kundër teje.** Më pastaj bariu zbriti nga froni, i veshi rrobat e veta, mori torbën dhe pa pritur shkoi,

në drejtim të panjohur.

Ndërsa mbreti mbeti gojëhapur duke menduar. Pastaj e kaploi një kërshtëri fëmijërore dhe pëshpëriti: Po, tashti po e kuptoj se ai që e njih veten e njih Zotin. Kush e njih Zotin, atëherë e ndien praninë e tij. Prandaj, unë tani e ndiej praninë e Krijuesit të gjithësisë! Kështu që m'u plotësua dëshira ime e flaktë përmes mësimdhënësit, bariut.

Në këtë moment ra zilha për përfundimin e orës së edukatës fetare. Mësuesi Muhammed doli nga klasa duke i përshëndetur nxënësit me përshëndetjen islame "Es- selamu alejkum", "ve alejkumus-selam", përgjigjen nxënësit, dhe ashtu të gëzuar për një mësim të ri dhe të dobishëm thanë njëzërit: **"... A mos keni dyshim në Allahun..."**

*Allahu vonon, por nuk harron.  
(proverb arab).*

Bij të mi dashur! Fëmijë të mi të nderuar!

Para se të ndahemi, do t'ju prezentojmë disa ajete kur'anore si dhe disa hadithe të pejgamberit Muhammed a.s., lidhur me këtë temë, në mënyrë që t'i mësoni përmendsh dhe t'i praktikoni në jetë.

*“Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet, e ai tha: “O populli im, adhurojeni Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij. Unë kam frikë për dënimin Tuaj në një ditë të madhe!” (El-A’raf, 59).*

*Musai tha: “Mos deshët, pos Allahut, të kërkoj për ju zot tjetër, kurse Ai ju vlerësoi mbi njerëzit e tjerë?” (El-A’raf, 140).*

*Atëherë, dije se nuk ka Zot tjetër pos*

*Allahut, kërko falje për mëkatin tënd, për të besimtarëve e të besimtareve, Allahu e di për lëshimet tuaja (për vepra) dhe për vendin tuaj. (Muhammed, 19).*

Ja, tani disa hadithe të pejgamberit Muhammed, paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të:

*"Njeri i mençur është ai që e kontrollon vetveten dhe punon për jetën pas vdekjes, kurse njeri i dobët është ai që ndjek dëshirat e epshit të vet dhe pa arsye (pa kurrfarë merite) shpreson se Allahu do t'ia falë".*

*" Frikësohu Allahut kudo që të jeshë, të keqën përcille me të mirë, ajo do ta fshijë të keqën. Dhe me njerëz bëhu i moralsbëm-me moral dhe sjellje të mira ."*

*"Nga Islami i mirë i një njeriu është*

*largimi nga ajo që nuk i përket".*

Vogëlushë të dashur !

Ejani me ne të mësojmë virtyte të tjera nga besimtarët, ku do të lexojmë një tregim tjetër të mësuesit Muhammed.

### I – 3 MOSKUPTUESHMËRIA NUK ËSHTË DËSHMI PËR MOSEKZISTENCË

Bij të mi të dashur! Fëmijë të mi të nderuar!

Pas përfundimit të orës së historisë shqiptare, dhe pushimit të shkurtër, filloi ora e edukatës fetare. Mësuesi

Muhammed hyri në klasë me buzëqeshje duke i përshëndetur nxënësit e tij si zakonisht me përshëndetjen islame "Es-selamu alejkum", "ve alejkumus-selam", përgjigjen nxënësit njëzëri, të gatshëm dhe me padurim presin ndonjë mësim të ri dhe të dobishëm nga mësuesi i tyre.

Në momentin kur mësuesi Muhammed deshi ta fillojë mësimin vërejti një nxënës që kishte ngritur dorën për ta pyetur, të cilit i dha leje.

Mësues i dashur, fjala *talebe* a është fjalë e gjuhës shqipe? pyeti nxënësi.

Fjala *talebe* (ar. طالب sh. *طلبة*), është fjalë e huazuar, respektivisht është fjalë e gjuhës arabe, tha mësuesi.

Cili prej jush e di domethënien e fjalës *talebe*? pyeti mësuesi. Kemali: Fjala *talebe* do të thotë: Nxënës në



medrese, u përgjigj ai. Kush di të shtojë diçka tjetër, pyeti mësuesi.

Heshtje e plotë! Asnjë nga nxënësit nuk përgjigjet, por qëndrojnë duke shikuar njëri-tjetrin në një topishmëri.

Pas kësaj, fjalën e mori mësuesi e tha:

Kjo fjalë ka kuptime të një dimensionit më të gjerë se sa që njihet tek ne. Prandaj fjala talebe ka shumë kuptime e ndër to: Ai që kërkon diçka; lutës; kursist; kandidat; hetues; hulumtues, kërkues; kadet; nxënës; student etj.

Këtu në këtë moment ma përkujtuat përgjigjen e një talebe të medresesë ndaj një profesori ateist, tha mësuesi dhe vazhdoi.

Profesori ateist, me një mjekër, i cili më shumë përpiquej ta imitojë Marksën,

Engelsin e të ngjashëm me ta, vajti në një medrese, për t'ju mbajtur ligjerata talebeve.

Ai posa hyri në klasë me një fodullitet, mendoj se talebet për çdo fjalë të tij do të thonë amin! Dhe, që në fillim iu drejtua talebeve:

- A e shihni murin? pyeti profesori ateist. Po, u përgjigjen talebet njëzëri.

- Pra, muri ekziston, tha mjekroshi ateist.

- A e shihni dërrasën e zezë? pyeti profesori. Po, u përgjigjen talebet njëzëri.

- Pra, dërrasa e zezë ekziston, tha ateisti.

- A i shihni bankat? pyeti mjekroshi ateist. Po, u përgjigjen talebet njëzëri.

- Pra, bankat ekzistojnë, tha

mësuesi.

- A më shihni mua, me këtë mjekër si të Marksit ? pyeti profësoni ateist. Po, u përgjigjen ata njëzeri.

- Pra, unë ekzistoj, tha profësoni ateist.

- A e shihni Zotin? pyeti mjekroshi ateist, në mënyrë cinike. Në këtë rast të gjithë talebet heshten!

- Ç'farë është me ju! A e ka parë ndonjëri prej jush Zotin? pyeti përsëri me plot mllef ateisti, duke iu drejtuar talebeve.

Jo, unë nuk e kam parë, përgjigjet një talebe. Profësoni ateist u gëzua shumë për këtë guxim të tij.

- Prandaj, për këtë motiv i pyeti përsëri të tjerët: Kush thotë se e ka parë Zotin? Asnjëri nuk përgjigjet!

- Pra, Zoti nuk ekziston, tha profesori ateist.

- Kush është në gjendje ta përsërit këtë që thashë më parë? pyeti profesori ateist. Këtu në këtë rast një talebe, ngriti dorën duke thënë:

Profesor, a me lejon që të flasë.

- Me gjithë zemër! Urdhëro, tha profesori ateist duke fërkuar duart.

Ky talebe me plot besim dhe guxim iu drejtua shokëve të tij, duke iu thënë pikërisht ashtu si profesori:

- A e shihni murin?

Talebet të tjerë u habiten për (ri) pyetjen e shokut të dashur, pikërisht ashtu si pyetja e profesorit ateist, megjithatë, ata si zakonisht, në pajtueshmëri njëzëri thanë: Po.

- Pra, muri ekziston, tha ky talebe.

- A e shihni dërrasën e zezë? pyeti talebja. Po, u përgjigjen ata.

- Pra, kjo dërrasë ekziston, tha talebja.

- A më shihni mua? pyeti talebja. Po, u përgjigjen ata njezëri.

- Pra, unë ekzistoj, tha ky talebe besimtar. Pastaj iu drejtua profesorit ateist duke i thënë:

- Profesor a më lejoni që të vazhdojë!

Profesori ateist, duke mos mundur të fsheh gëzimin për këtë talebe të suksesshëm, i cili sipas mendimit tij të gjithë talebet janë si papagaj dhe përsëritin vetëm atë që thotë ai, prandaj me gjithë qejf i tha: Urdhëro! Urdhëro, e vetëm vazhdo se kështu do të bëhesh profesor si unë!

Atëherë ky talebe me plot besim, zgjuarsi dhe guxim, iu drejtua shokëve

të tij duke u thënë:

- A e shihni mendjen e profesorit?

Jo, jo, jo. Njëzëri u dëgjua britma e talebeve, me plot besim, zgjuarsi dhe guxim.

Profesori ateist mbeti i shtangur nga habia dhe i dridhej mjekra, sepse ai nuk kishte mjekër për Qabe. Kështu që ai vajti për lesh dhe doli i qethur, respektivisht vajti për t'i kërkuar llogari dikuj, po i kërkuan llogari atij vetë dhe e vunë përpara. E kështu është kur djalli s'ka dele dhe shet lesh!

Atëherë, ky talebe besimtar i thotë: Ju profesor, sigurisht e dini para meje se:

**Moskuptueshmëria, s'është  
dëshmi për mosekzistim!**

Nxënës të dashur!

A e kuptuat përgjigjen e këtij talebe të zgjuar? pyeti mësuesi Muhammed. Po, por...

Çka por? tha mësuesi Muhammed.

Kemali: Si mund të thonë se profesori ateist s'ka mendje! pyeti nxënësi.

*Natyrisht ky talebe besimplotë dhe guximtar, nuk ka pasur për qëllim të thotë se profesori ateist nuk ka mendje. Por qëllimi i tij ishte që t'i tregojë mjekroshit ateist se vërtet ai nuk mund ta gjejë Krijuesin e gjithësisë vetëm përmes pesë shqisave, që s'është dëshmi për mosekzistencën e Zotit. Por, ekziston "instrumenti" i logjikshëm për njohjen e Krijuesit, e ai "instrument" është mendja, të cilën mjekroshi ateist nuk e ka shfrytëzuar*

*gjegjesisht nuk është shërbyer me mendje, tha mësuesi Muhammed.*

Në këtë moment ra zilja për përfundimin e orës së edukatës fetare. Mësuesi Muhammed doli nga klasa duke i përshëndetur nxënësit e tij si zakonisht me përshëndetjen islame “Es-selamu alejkum”, “ve alejkumus-selam”, përgjigjen nxënësit dhe ashtu të gëzuar për një mësim të ri dhe të dobishëm duke thënë:

**Moskuptueshmëria s’është  
dëshmi për mosekzistencë.**

*Kush thotë: Unë jam i dijsbëm, ai  
është i padijsbëm.*



Bij të mi të dashur! Fëmijë të mi të nderuar!

Para së të ndahemi, do t'ju prezentojmë disa ajete kur'anore dhe disa hadithe të pejgamberit Muhammed. a.s, lidhur me këtë temë, në mënyrë që t'i mësoni përmendsh dhe t'i praktikoni në jetë.

*Musai tha: “Mos deshët, pos Allahut, të kërkoj për ju zot tjetër, kurse Ai ju vlerësoi mbi njerëzit e tjerë?” (El-A’raf, 140).*

*“Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet, e ai tha: “O populli im, adhurojeni Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij. Unë kam frikë për dënimin Tuaj në një ditë të madhe!” (El-A’raf, 59).*

“Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

*“Thuaj: Ai, Allahu është Një! Allahu*

*është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë".*

Ja tani disa hadithe te pejgamberit Muhammed (a.s.) paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të:

*" Frikësohu Allahut kudo që të jeshë, të keqën përcille me të mirë, ajo do ta fshijë të keqën. Dhe me njerëz bëhu i moralshëm-me moral dhe sjellje të mira ."*

*"Njeri i mençur është ai që e kontrollon vetveten dhe punon për jetën pas vdekjes, kurse njeri i dobët është ai që ndjek dëshirat e epshit të vet dhe pa arsye (pa kurrfarë merite) shpreson se Allahu do t'ia falë".*

Vogëlushë të dashur!

Ejani me ne të mësojmë virtyte të tjera nga besimtarët , ku do të lexojmë një tregim nga tregimet e mësuesit Muhammed.